



Npi – 01/285 datë: 30.08.2023

Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (d) nenin 40.2 shkronja (b) dhe nenin 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenet 60 dhe 61 të Ligjit për Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-48; Udhëzim Administrativ MAPL-së Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna; Nenin 11 të Rregullores Komunale për Transparencë, Npi – 01/288 datë: 26.09.2019; Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 30.08.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR DISKUTIM PUBLIK TË PLANIT BUXHETOR TË KOMUNËS SË SHTIMES PËR VITIN 2025

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -VIII- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 30.08.2024, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Planin Buxhetor të Komunës së Shtimes për vitin 2025, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim, dhe Komitetin për Politikë e Financa.

II

Kuvendi i Komunës ka marrë për bazë edhe rekomandimin nga Komiteti për Politikë dhe Financa, Npi-01/281 dt.28.08.2024, dhe Rekomandimi nga Komiteti për Komunitete Npi-01/278 dt.27.08.2024.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi